



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Beni Com" SHPK të datës 26.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Beni Com" SHPK të datës 26.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Beni Com" SHPK (tutje "parashtruesi") me datë 26.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit manifestohen duke kundërshtuar arsyet për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm
 Çmimi jo-normalisht i ulët

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si GOE-ik me ofertën tuaj keni dorëzuar oferte me çmime jo normalisht të ulët. Për Loto 5 dhe 6. Bazuar në LPP dhe RRPP për çmimin jo -normalisht të ulët konstatojmë se ju si GOE-ik keni ofruar çmimin jo normalisht të ulët mbi 30 % të mesatares se ofertave të përgjegjshme, dhe 10% në mes ofertës me të lire në krahasim me ofertën e dytë me të lire. Të bashkëngjitur e gjeni edhe formulën e kalkulimit si dëshmi:

⁵ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Nr	A	B	C
1	Kushti 1 është përbushur kushti sepse janë pranuar 3 oferta të përgjegjshme	Pranuar 3 oferta	
2		1	869,533.00
3		2	1,162,881.00
4		3	1,221,459.33
5		4	1,238,127.67
6			
7			
8		Totali (C2-C6)	4,492,001.00
9		Mesatarja (C8/4)	1,123,000.25
10	Kushti 2 : të gjitha ofertat nën këtë çmim përbushin kushtin e dytë	Pragu 30% (mesatarja /1.3)	863,846.35
10	Kushti 3 : pragu 10% në mes ofertës me të lire në krahasim me ofertën e dytë me të lire	Pragu 10% (oferta e dytë /1.1)	1,057,164.55

Figura 1.

Andaj për arsye të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

Me rastin e administrimit me dokumentet me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur se çmimi me të cilin ka ofertuar parashtruesi është çmim dukshëm jonormalisht i ulët. Ndër të tjera është konfirmuar se çmimi i parashtruesit është mbi 30% më i ulët se mesatarja e të gjitha ofertave tjera por edhe mbi 10% më i ulët se çmimi i dytë më i lirë me radhë pas parashtruesit. Pra në kuptim të nenit 41 të RRPP dhe 61 të LPP lidhur me nenin 59 par. 4 të LPP, komisioni vlerësues me të drejtë ka gjetur se oferta e parashtruesit duhet eliminuar si e papërgjegjshme.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Vlen të shtohet po ashtu se edhe në rastin hipotetik më të favorshëm për parashtruesin, kur i njëjti do të kishte dorëzuar ofertë të përgjegjshme, sërish çmimi me të cilin ka ofertuar parashtruesi nuk do të ishte kombinimi optimal i kostos në raport me të gjitha lotet e këtij aktiviteti të prokurimit duke marrë parasysh kriterin e dhënies së kësaj kontrate si tenderi ekonomikisht më i favorshëm. Me fjalë të tjera parashtruesi edhe po të mos eliminohej si i papërgjegjshëm, sërish do të ishte tenderues i pasuksesshëm dhe nuk do të mund të cilësohej si tenderues i suksesshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Lidhur me këtë vlen të citohet edhe neni 27 par. 8 në LPP ku përcaktohet se *“ Është obligim i Departamentit/ Njesisë së Prokurimit/ të siguroj që blerja më e mirë (vlera ekonomikisht më e favorshme) të sigurohet duke marrur parasysh kombinimin optimal të kostos”*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.